



Republika e Kosovës
Republika Kosovo
Republic Of Kosovo



REPUBLIKA E KOSOVES
REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA E KAÇANIKUT
OPŠTINA KAÇANIK



Kuvendi i Komunës
Skupština Opština
Municipal Assembly

Data	05.04.2019	Vendi	KAÇANIK
Nj. org.		Numri	
	01-370 /	01-10671	-/.

KONTRATË PUNE

Komuna e Kaçanikut, përfaqësuar nga Shefket Koxha, (në vazhdim "Autoriteti Kontraktues"), në njërën anë; dhe

NTP "MALI ART" të cilën e përfaqëson Muharrem Berisha nga Kaçanik (në vazhdim "Kontraktuesi"), në anën tjetër, janë pajtuar të lidhin një kontratë publike për punë e shënuara me poshtë:

"Ndertimi i kanalizimeve fekale dhe atmosferik- Kontratë njëvjeqare"

me numër identifikues: KA652/19/009/521

Neni 1 Lënda

1.1 Lënda e kontratës është ekzekutimi i punëve në vijim nga ana e Kontraktuesit:

"Ndertimi i kanalizimeve fekale dhe atmosferik- Kontratë njëvjeqare"

Neni 2 Çmimi

2.1 Çmimi total i punëve duhet të jetë: 78.682,78 €;
(Shtatëdhjetë e tetë mijë e gjashtëqind e tetëdhjetë e dy euro dhe 78/100€).

2.2 Çmimi i përmendur në Nenin 2.1 më sipër duhet të jetë e vetmja pagesë që Autoriteti Kontraktues i ka borxh Kontraktuesit sipas kontratës. Ai duhet të jetë i prerë dhe të mos i nënshtrohet ndryshimeve.

2.3 Pagesat do të bëhen në pajtim me Kushtet e përgjithshme dhe/ose të Veçanta të kontratës.

2.4 Punëdhënësi pajtohet ta paguaj kontraktuesin dhe atë: Në bazë të punëve të kryera pas raportit me shkrim nga ana e menagjerit të projektit, ndërsa situacioni përfundimtar paguhet pas raportit përfundimtar të menagjerit të projektit si dhe raport teknik të komisionit për praninë teknik të punëve.

Neni 3 Rendi i përparësisë i dokumenteve të kontratës

3.1 Kontrata përbëhet nga dokumentet në vijim:

- Marrëveshja e kontratës;
- Kushtet e Veçanta të Kontratës;
- Kushtet e Përgjithshme të Kontratës;
- Tënderi i Kontraktuesit, duke përfshirë edhe Specifikimet Teknike;
- Cferta financiare (Paramasa dhe Parallogaria);
- (Procesverbali i mbledhjes informative/vizitës së vendit)
- Plani mbi menaxhimin e Kontrates.

3.2 Dokumentat e ndryshme që e përbëjnë kontratën konsiderohet se shpjegojnë njëra tjetrën; dhe në raste të paqartësisë ose divergjencës, ato duhet të lexohen sipas rendit të përparësisë në të cilin janë dhënë më sipër.

Neni 4 Komunikimet

4.1 Të gjitha komunikimet me shkrim që kanë të bëjnë me këtë Kontratë ndërmjet Autoritetit Kontraktues, nga njëra anë dhe Kontraktuesit nga ana tjetër duhet të cekin titullin e Kontratës dhe numrin e saj të identifikimit dhe duhet të dërgohen me postë, faks, email ose të dorëzohen personalisht. Komunikimet për Autoritetin Kontraktues mund të adresohen Autoritetit Kontraktues ose Menaxherit të Projektit i emëruar në Kushtet e Veçanta të Kontratës.

4.2 Nëse personi që dërgon komunikatën kërkon vërtetim të pranimit të saj, ai duhet ta thotë këtë në komunikatën e tij. Sa herë që ka afat të fundit për pranimin e komunikatës me shkrim, dërguesi duhet të kërkojë vërtetim të pranimit të komunikatës së tij. Në të gjitha rastet, dërguesi duhet t'i marrë të gjitha masat e nevojshme për të siguruar pranimin e komunikimit të tij.

4.3 Kudo në kontratë parashikohet për dhënien e ndonjë njoftimi, pëlqimi, miratimi, certifikate, ose vendimi, përveç nëse specifikohet ndryshe në njoftim të tillë, pëlqim, miratim, certifikatë apo vendim do të jetë në formë të shkruar dhe fjalët "njofton", "vërtetojë", "miratoj" ose "vendosë" do të interpretohen në përputhje me rrethanat. Ndonjë miratim, pajtim, certifikatë ose vendim i tillë nuk duhet të mbahet apo vonohet pa arsye.

4.4 Kjo kontratë është e përgatitur në gjuhën shqipe në tri origjinale, dy prej të cilave janë për Autoritetin Kontraktues dhe një origjinale për Kontraktuesin.

Për Autoritetin Kontraktues

Emri:	Shefket Koxha
Pozita:	Zyrtar përgjegjës i prokurimit
Nënshkrimi:	
Data:	05.04.2019
Vula:	



Për Kontraktuesin

Emri:	Muharrem Berisha
Pozita:	Drejtor
Nënshkrimi:	
Data:	05.04.2019
Vula:	



kontraktuesit, diferenca do të jetë obligim borxhi ndaj Autoritetit 39.2 Nëse kontrata ndërpritet për shkak të interesit të Autoritetit Kontraktues ose shkeljes materiale bazë të kontratës nga Autoriteti Kontraktues, Menaxheri i Projektit do të lëshoj një certifikatë për vlerën e punës së bërë, materialet e porositura, koston e arsyeshme të haqjes së Pajti,eve, riadhesimin e personelit të Kontraktuesit i punësuar vetëm për Punët, shpenzimet e Kontraktuesit për mbrojtjen dhe sigurimin e Punëve dhe pagesat në avans të marra deri në datën e certifikatës.

Neni 40 Prona

40.1 Të gjitha materialet dhe pajisjet e ndërtimit në vend punim, Implantet, Punët e Përkohshme, dhe Punët do të konsiderohen të jenë pronë e Autoritetit Kontraktues nëse Kontrata ndërpritet për shkak të gabimit të Kontraktuesit.

Neni 41 Lirimi nga Ekzekutimi

41.1 Në qoftë se pamundësohet përbushja e kontratës nga shpërthimi i luftës apo ndonjë rasti tjetër jashtë kontrollit të Autoritetit Kontraktues ose Kontraktuesit, Menaxheri i Projektit do të vërtetoj këtë. Kontraktuesi do të siguroj vend punimin dhe do të ndërpres punën sa më shpejt që është e mundur pas pranimit të këtij vërtetimi dhe do të paguhet për punët e kryera para pranimit të tij dhe për punët e kryera më pas për të cilat është arritur marrëveshje.

Neni 42 Zgjidhja miqësore e mosmarrëveshjeve

42.1 Palët do t'i bëjnë të gjitha përpjekjet për të zgjidhur në mënyrë miqësore të gjitha mosmarrëveshjet që mund të ndodhin ndërmjet tyre. Sapo të shfaqet ndonjë mosmarrëveshje, Palët do ta lajmërojnë njëra tjetrën me shkrim për pozitën e tyre në mosmarrëveshje dhe për ndonjë zgjidhje që ata konsiderojnë se është e mundshme. Nëse cilado Palë e shih të dobishme, palët do të takohen dhe të mundohen ta zgjidhin mosmarrëveshjen. Pala do të i përgjigjet kërkesës për zgjidhje miqësore brenda 15 ditësh pas kërkesës. Periudha maksimale që jepet për arrijen e kësaj zgjidhjeje do të jetë 30 ditë nga fillimi i procedurës. Nëse përpjekja për të arritur zgjidhje miqësore dështon ose nëse Pala dështon të përgjigjet me kohë ndaj kërkesave për zgjidhje, të dyja palët do të jenë të lira të vazhdojnë në fazën e ardhshme të procedurës së zgjidhjes së mosmarrëveshjes duke e lajmëruar tjetrën.

42.2 Nëse procedura e zgjidhjes miqësore të mosmarrëveshjes dështon, palët mund të marrin vesh të përpigjen të pajtohen përmes institucionit të specifikuar në KVK. Nëse nuk mund të arrihet zgjidhja brenda 30 ditësh pas fillimit të procedurës së pajtimit, secila palë do të ketë të drejtë të vazhdojë në fazën e ardhshme të procedurës së zgjidhjes së mosmarrëveshjes.

Neni 43 Zgjidhja e mosmarrëveshjeve me procedurë gjyqësore

43.1 Nëse nuk mund të arrihet zgjidhje brenda 30 ditësh nga fillimi i procedurës miqësore për zgjidhje të mosmarrëveshjes, secila palë mund të kërkojë:

- a) ose vendim nga gjyqi;
- b) kurdo që palët pajtohen vendim arbitrimi në pajtim me KVK.

43.2 Para nënshkrimit të kontratës palët duhet të vendosin për mënyrën e zgjidhjes së mosmarrëveshjes, gjykata apo arbitrimi.

PJESA III E KONTRATES KUSHTET E VEÇANTA

KVK në vijim do të plotësojnë dhe/ose ndryshojnë KPK. Sa herë që ka një konflikt, dispozitat këtu do të mbizotërojnë mbi ato të KPK.

[Udhëzimet për plotësimin e KVK janë dhënë, sipas nevojës, në shënime kursivo të përmendura për nenet përkatëse të KPK. Fshini ato jo relevante]

Kushtet e Përgjithshme të Kontratës	Amandamentet/Modifikimi i Nenit përkatës në KPK
-------------------------------------	---

Përshkrimi i nenit	Neni, Nr.	
Ligji i zbatueshëm dhe gjuha	2.1	Ligjet e Kosovës që janë në fuqi do të zbatohen për të gjitha çështjet që nuk mbulohen nga dispozitat e kontratës. Juridiksioni do të jetë gjykata përkatëse në Prishtinë.
	2.2	Gjuha e përdorur do të jetë shqipe
Siguria e ekzekutimit	10.1	Shuma e sigurisë së ekzekutimit është 10% e Vlerës së Kontratës apo 7868,27€.
Përgjegjësia dhe Sigurimi Kontraktuesit	11.2	Shuma minimale e sigurimit do të jetë: (a) Për humbje ose dëmtim të Punëve, Impianteve dhe Materialeve [shëno shumat]; (b) humbje ose dëmtim i Pajisjeve [shëno shumat]; (c) humbje ose dëmtim i pronës (përveç Punëve, Impianteve, Materialeve dhe Pajisjeve) në lidhje me Kontratën [shëno shumat]; (d) dëmtim personal ose vdekje: (i) të punëtorëve të Kontraktuesit: [shëno shumat] (ii) të personave të tjerë: [shëno shumat]
Programi	12.1	Kontraktuesi do ta dorëzojë për aprovim Programin për Punët brenda 3 ditëve nga data e nënshkrimit të kontratës.
	12.2	Periudha për Programin e azhurnuar është [shëno numrin] ditë
Fillimi i punëve	17.1	Data e fillimit do të jetë 10.04.2019 ku i gjithë plani dinamik aratohet në ditar ndërtimor.
	17.2	Data e përfundimit e të gjitha Punëve do të jetë pas një viti më 09.04.2020
Dëmet e likuiduara	19.1	Dëmet e likuiduara për të gjitha Punët janë 0.25% përqindjen e Çmimit përfundimtar të Kontratës për ditë. Shuma maksimale e dëmeve të likuiduara për të gjitha Punët është 10% e Çmimit final të Kontratës.
Regjistri i punës	20.1	[Specifikoni nëse një regjister i punës nuk nevojitet].
Inspektimi dhe testimi	22.1	Menaxheri i Projektit është Hajredin Shehu
Parapagimi	26.1	Shuma e Parapagimit është: 10% e vlerës së Kontratës
Mbajtja e Parasë	27.1	Shuma e parave të mbajtura është: Shuma, e specifikuar në KVK, do të ndalet nga çdo pagesë nga 10% e vlerës së pageses e Kontraktuesit deri në përfundim të tërë të Punëve. Kjo shume në asnjë rast nuk do të tejkalojë 10% e vlerës totale të kontratës origjinale.
Shkaqet kompensim	per 30.1	Data e posedimit të vend punimit do të jetë 5 pesë ditë pas nënshkrimit të kontratës.

Përgjegjësia Defektet	mbi	34.5	Perludha garantuese e defekteve është 365+30 ditë
Pagesa shkëputjes kontratës	pas së	39.1	Përqindja që do të zbatohet për vlerën e punëve që nuk janë përfunduar, që përfaqëson koston shtesë të Autoritetit Kontraktuesin për kompletimin e Punëve, është <i>[shëno përqindjen]</i> .
Zgjidhja miqësore e mosmarrëveshjeve		42.2	<i>[Specifikoni departamentin e Komisionit përgjegjës për pajtim]</i>
Zgjidhja e mosmarrëveshjeve me procedurë gjyqësore	e	43.1	<i>[shëno të dyja]</i> <p>a) Çdo mosmarrëveshje ndërmjet palëve të cilat mund të lindin gjatë ekzekutimit të kësaj kontrate dhe se nuk është e mundur të zgjidhet ndryshe ndërmjet palëve do të dorëzohet <i>[grykatën kompetent në pajtim me ligjin në Kosovë]</i>.</p> <p>ose</p> <p>b) kurdo që palët pajtohen, çdo mosmarrëveshje ndërmjet palëve të cilat mund të lindin gjatë ekzekutimit të kësaj kontrate dhe se nuk është e mundur të zgjidhet ndryshe ndërmjet palëve do të dorëzohet në arbitrazh të <i>[specifiko organin për zgjedhjen e mosmarrëveshjes] në pajtim me [specifiko rregullat e arbitrazhit (rregullat e Dhomës Ndërkombëtare të Tregtisë, Komisioni i Kombeve të Bashkuara mbi Ligjin e Tregtisë Ndërkombëtare, apo procedura të tjera të arbitrazhit të njohura ndërkombëtarisht)]</i>.</p>